



PROTOKOLLI MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19 SHËRBIMI TAXI

- Shërbimi taksi ofrohet vetëm për transport brenda qytetit. Në asnjë rast nuk lejohet transporti ndërqytetas. Në rast kontrolli nga organet e policisë, pasagjeri duhet të tregojë arsyet e lëvizjes së tij në përputhje me ligjin. Në rast se automjeti kryen lëvizje ndërqytetase përgjegjësia bie mbi subjektin si dhe shoferin.
- Administratori/Personi Fizik Tregtar kryen çdo ditë vetëvlerësimin personal dhe të personave të punësuar nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas checklistës së miratuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127.
- Çdo shofer është i detyruar të deklarojë nëse ka patur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.
- Çdo punonjës/tregtar që vëren shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqitet në punë dhe duhet të lajmërojë menjëherë përfaqësuesin e entit administrues të tregut. Punonjësi duhet të telefonojë 127 dhe mjekun e familjes.
- Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar.
- Personeli i punësuar/Administratori/Personi Fizik Tregtar duhet të përdorë në çdo moment dorezat mbrojtëse. Dorezat ndërrohen çdo ditë.
- Personeli i punësuar/Administratori/Personi Fizik Tregtar duhet të mbajë në çdo moment maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën. Maska ndërrohet çdo 3 ditë.
- Maskat, higjenizuesi dhe dorezat sigurohen nga subjekti pronar. Maskat mund të jenë edhe prej cope dhe në këtë rast duhet të ndërrohen çdo ditë.
- Në automjet duhet të ofrohet produkti higjenizues të duarve për klientët dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60%.
- Klienti dezinfekton duart në hyrje dhe dalje nga automjeti. Klienti mban dorezat dhe maskën mbrojtëse çdo moment.
- Pasagjeri ulet gjithmonë mbrapa dhe diagonalisht me shoferin e mjetit.
- Lejohet vetëm 1 klient në automjet në çdo rast, edhe kur udhëtarët janë nga një familje. Përjashtim bëjnë vetëm rastet e shoqërimit nga fëmijë të mitur apo persona me paaftësi.
- Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik pasagjer-shofer.
- Kollitja dhe tështitja kryhen duke përdorur bryllin apo letër hundësh. Letra hidhet menjëherë në kosh.

- Shoferi kur kthehet në banesën e tij heq maskën dhe dorezat dhe lan duart e fytyrën për 20 sekonda me ujë dhe sapun. Dorezat dhe maska sipas rastit hidhen në kosh të mbyllur.
- Shoferët duhet të nxjerrin rrobat dhe uniformat e tyre në diell dhe ajrim pasi kthehen në banesë. Rrobat dhe uniformat duhet të lahen çdo 2-3 ditë.
- Kondicioneri duhet të jetë fikur dhe ajrosja të jetë natyrale.
- Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të automjetit dhe larje pas çdo turni, sidomos të dorezave të dyerve e sediljeve.
- Subjekti duhet të sigurojë ajrim sipas mundësisë minimalisht 5 herë në ditë.
- Pas veprimeve me cash/karta krediti shoferi dezinfekton duart me higjenizues.
- Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.
- Subjekti duhet të afishojë detyrimin për vetëvlerësim të simptomave nga klientët dhe personeli i punësuar/administratori/personi fizik tregtar sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.